



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 67, datë 12.06.2020

**“PËR
RIORGANIZIMIN E QENDRAVE SOCIALE TË BASHKISË TIRANË, NË QENDRA
KOMUNITARE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “b” dhe “ç”, nenit 24, nenit 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 5, shkronja “d”, të Ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, pikës 17, të vendimit nr. 165, datë 02.03.2016, të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, udhëzimit nr. 689, datë 2.10.2018, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”, Vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Riorganizimin e Qendrës Sociale Multidisiplinare, Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku” dhe Qendra Multifunkionale Komunitare Shkozë, në Qendra Komunitare me të njëjtin emërtim (në vijim, Qendra), si institucione në varësi të Bashkisë Tiranë.
2. Qendrat komunitare kanë këto funksione dhe përgjegjësi:
 - a) identifikimin, vlerësimin, informimin dhe këshillimin psiko-mediko-social për fëmijët, të rinjtë, individët dhe familjet në nevojë;
 - b) shërbime sociale bazë përmes ndërmjetësve të komunitetit, duke përfshirë lehtësimin e regjistrimit të statusit civil, qasjen në shërbimet shëndetësore bazë, regjistrimin dhe ndjekjen e mbështetjes në arsimin parashkollor dhe fillor, lehtësimin e trajnimit profesional dhe stërvitje punësimi, përfshirjen e fëmijëve në klasa arti, sporti dhe muzike, në gamën e lojrave në natyrë dhe ngjarjet relevante kulturore;
 - c) shërbime këshilluese ndërmjetësuese lidhur me strehimin social, punësimin dhe aspektet ligjore;

- d) parandalimin e braktisjes, institucionalizimit dhe trafikimit të fëmijëve;
- e) parandalimi i formave të rënda të punës së fëmijëve;
- f) integrimi i individëve me probleme sociale dhe të zhvillimit;
- g) ofrimi i programeve të fuqizimit të familjes dhe individit;
- h) ofrimi i ndërhyrjes së hershme për fëmijët me aftësi të kufizuar të moshës deri në 6 vjeç;
- i) ofrimi i shërbimeve për krijimin e jetës së pavaruar për individët me aftësi të kufizuar të moshës 16-30 vjeç;
- j) zhvillimin e trajnimeve, ëorkshope, takime me individë, prindër dhe anëtarë të pakicave të ndryshme, për rritjen e kapacitetit të tyre në fushat e shërbimeve sociale;
- k) vizita në familje;
- l) advokaci dhe lobim; si dhe çdo detyrë tjetër të përcaktuar në legjislacionin në fuqi ose të ngarkuar nga Kryetari i Bashkisë, që lidhen me funksionet e njësive të vetëqeverisjes vendore në fushën e shërbimeve sociale.

3. Qendra do të jetë funksionale sipas fashës orare nga e hëna në të premte ora 08⁰⁰ - 20⁰⁰ dhe ditën e shtunë orari 09⁰⁰-14⁰⁰.

4. Qendrave komunitare i'u shtohen nga 2 (dy) punonjës secilës, duke e rritur numrin e përgjithshëm në 79 (shtatëdhjetë e nëntë) punonjës, të ndarë si më poshtë:

- a. Qendra Komunitare Shkozë: 26 punonjës;
- b. Qendra Komunitare Multidisiplinare: 26 punonjës;
- c. Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”: 27 punonjës.

5. Qendra komunitare drejtohet nga Drejtori i Qendrës i cili emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e Qendrës. Punonjësit emërohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

6. Të miratojë nivelin e pagave për punonjësit e Qendrave Komunitare, sipas lidhjes së pagave nr. 9, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Niveli i kuotave financiare për shpenzimet ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendër përcaktohet në vendimin nr. 89, datë 26.08.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të kuotave financiare për shpenzime ditore të ushqimeve për personat që përfitojnë shërbime në qendrat sociale të përkujdesit shoqëror në varësi të Bashkisë Tiranë”.

8. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Aparatit të Bashkisë për vitin 2020, duke reflektuar shtesat dhe pakësimet brenda programit të Planifikim, Menaxhim dhe Kujdes Social, për Familjet dhe Fëmijët, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

9. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të miratojë strukturat organizative dhe rregulloret e organizimit dhe funksionimit të brendshëm të qendrave komunitare, si dhe çdo akt tjetër të nevojshëm në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

10. Bashkia Tiranë iu siguron qendrave mjediset e nevojshme, nga inventari i saj i pronave të paluajtshme apo ambiente të tjera të kontraktuara ndaj të tretëve, për ushtrimin e veprimtarisë së tyre.

11. Në rastin e sigurimit të pasurive në administrim të Bashkisë Tiranë, ngarkohet Kryetari i Bashkisë për ndjekjen e procedurave të dorëzimit dhe kalimit kapital të pasurive, objekt i ushtrimit të detyrave funksionale, sipas të këtij vendimi dhe akteve të dala në zbatim të tij.

12. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi:

- a) Qendra Sociale Multidisiplinare, Qendra Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Qendra Komunitare Shkozë, shpërbëhen si institucione varësie dhe të gjitha aktivet e pasivet e këtyre institucioneve, i transferohen automatikisht qendrave komunitare;
- b) të gjitha zyrat, ambientet e punës, mjetet, pajisjet, dokumentacioni dhe fondet buxhetore të qendrave sociale i transferohen qendrave komunitare;
- c) të gjitha kontratat dhe marrëveshjet e bashkëpunimit në fuqi, të lidhura nga qendrat sociale me palë të treta, i transferohen qendrave komunitare.

13. Për punonjësit aktualë të qendrave sociale, zbatohen përcaktimet ligjore të Kodit të Punës që rregullojnë transferimin e marrëdhënieve të punës. Për ndjekjen e procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, qendra mund të asistohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore.

15. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, çdo akt i Këshillit Bashkiak apo Kryetarit të Bashkisë që referon në aktet e krijimit të qendrave sociale apo ngarkon me detyra të veçanta këto njësi, referenca do të vlerësohet si e bërë në qendrat e reja komunitare.

16. Vendimi nr. 11, datë 5.4.2012, i Këshillit Bashkiak “Për ristrukturimin e Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, “Qendrës Komunitare Multidisiplinare për fëmijët dhe familjen në nevojë” dhe “Qendrës Komunitare për të Moshuarit”, miratimin e strukturave të tyre organizative si dhe rishpërndarjet në buxhetin e Bashkisë së Tiranës për vitin 2012”, i ndryshuar; Vendimi nr. 60, datë 24.12.2012, i Këshillit Bashkiak “Për krijimin e Qendrës Komunitare Shkozë dhe miratimin e strukturës së saj organizative si dhe një shtesë në numrin e përgjithshëm të strukturës organizative të Qendrës Sociale “Të qëndrojmë së bashku”, Qendrës Sociale Multidisiplinare dhe Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët”, i ndryshuar, dhe pika 4, e Vendimit nr. 35, datë 5.4.2017, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve, Qendrës Kulturore “Tirana”, Klubit Sportiv “Tirana”, qendrave sociale dhe Qendrës Rinore “Ten”, i ndryshuar, shfuqizohen.

17. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Qendra Komunitare Shkozë, Qendra Komunitare Multidisiplinare, Qendra Komunitare “Të qëndrojmë së bashku”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

18. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

K R Y E T A R

TONI GOGU

Konceptoi:
E.Demiraj